

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Susan Sarandon zbulon pse nuk u martua me Tim Robbins pas 23 vitesh bashkë? “Kam frikë se mos...”
ADRESA	https://piranjat.al/showbiz/susan-sarandon-zbulon-pse-nuk-u-martua-me-tim-robbins-pas-23-vitesh-bash-i104596
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 07:45:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 07:40:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	360e09784bb5a07389ee6ee8eebc44f4fc4c04a69df25c4abf24c440ec9ecf30
TEKSTI	8e2b94dd241f7185110136b8a6d5a89610b972871c211f9f0176b1d6e6716e6b
PAMJA	26dd7be262b92c29247a14815088dbe0157d39156b393cf428c4462aa170b903

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	712d3922c4fa29e194ce5e5de6f5f9c3a2e0749595bb715526c6d504ebc0fa7a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	81c8c13b2047f7f67d44b50c2b734087e798480a3f28f7a7cb4e41f88dd32922
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/712d3922c4fa29e194ce5e5de6f5f9c3a2e0749595bb715526c6d504ebc0fa7a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **Pozitive që s'u nio** **te Gjirit për luftën** **mbretin Charles pas** **zonën me gardh metalik** **rreth 6 kg kanabis**

SHOWBIZ

Susan Sarandon zbulon pse nuk u martua me Tim Robbins pas 23 vitesh bashkë? “Kam frikë se mos...”

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 09:40



Susan Sarandon dhe Tim Robbins kaluan 23 vite së bashku, rritën dy fëmijë dhe për shumë kohë u konsideruan një nga çiftet më jetëgjata të Hollywood-it. Por, pavarësisht lidhjes së tyre të gjatë, ata nuk u martuan kurrë.

[Sarandon ka shpjeguar](#) ndër vite se arsyeja nuk ishte mungesa e dashurisë apo përkushtimit, por pikërisht frika se martesë mund të ndryshonte dinamikën e marrëdhënies së tyre.

Aktorja ka thënë se nuk donte që formalizimi i lidhjes të bënte që njëri prej tyre të fillonte ta merrte tjetrin “si të mirëqenë”. Sipas saj, të mos qenit të martuar i detyronte të dy që të zgjidhnin njëri-tjetrin vazhdimisht.

Nuk do të martohem sepse kam shumë frikë se mos e marr atë si të mirëqenë ose ai më merr mua si të mirëqenë

-kishte deklaruar Sarandon në një intervistë të cituar nga People.

Ajo madje kishte bërë shaka se martesë mund të shërbente si një arsye për të organizuar një festë kur të mbushte 80 vjeç.

[Sarandon](#) dhe Robbins u njohën gjatë xhirimeve të filmit “Bull Durham” në vitin 1988. Marrëdhënia e tyre u shndërrua në një lidhje shumëvjeçare dhe së bashku patën dy djem, Jack dhe Miles.

Për Sarandon, megjithatë, ideja e martesës nuk kishte qenë kurrë një ëndërr. Ajo ishte martuar më parë me aktorin Chris Sarandon, me të cilin ishte bashkuar kur ishte shumë e re, por martesë përfundoi në vitin 1979. Më pas, aktorja nuk e konsideroi më martesën si një domosdoshmëri për të ndërtuar një familje.

Në një intervistë të hershme, Sarandon kishte shpjeguar edhe më qartë filozofinë e saj. Sipas saj, kur dy njerëz nuk janë të lidhur nga formula tradicionale e martesës, ekziston një nevojë më e madhe për të rikonfirmuar vazhdimisht dashurinë dhe zgjedhjen për të qëndruar bashkë.

Kur nuk je i martuar, mendoj se nuk është aq e lehtë ta marrësh tjetrin si të mirëqenë

-kishte thënë ajo, duke shpjeguar se nuk donte që partneri të shndërrohej thjesht në një “rol” brenda familjes.

Pavarësisht filozofisë së saj për martesën, lidhja me Robbins nuk zgjati përgjithmonë. Pas 23 vitesh së bashku, çifti u nda në vitin 2009. Përfaqësuesja e Sarandon konfirmoi në atë kohë se ata ishin ndarë gjatë verës, pa dhënë detaje të tjera.

Pas ndarjes, Sarandon pranoi se edhe vetë ishte befasuar nga fundi i marrëdhënies.

Nuk mendoia se do të ndodhte kurrë

-tha ajo, duke shpjeguar se ndonjëherë njerëzit hyjnë në jetën tonë për një periudhë të caktuar dhe se një marrëdhënie mund ta përmbushë misionin e saj pasi çifti të ketë krijuar familje.

Historia e Sarandon dhe Robbins mbetet një shembull i një marrëdhënieje që për më shumë se dy dekada funksionoi pa një martesë ligjore. Për aktoren, lidhja nuk përcaktohej nga një dokument, por nga zgjedhja e përditshme për të qëndruar bashkë, një filozofi që ajo e kishte mbrojtur shumë përpara se çifti t'i jepte fund marrëdhënies.

Artikuj te sugjeruar

SHOWBIZ 16 Shtator22:02

[Libri i Charles Spencer zbulon përplasjen me mbretin Charles pas vdekjes së Lady D: Do ta harrojmë shpejt Dianën](#)

Familja mbretërore britanike pritet të përballlet me zbulime të reja mbi periudhën pas vdekjes së Princeshës Diana, përme...

SHOWBIZ 16 Shtator19:41

[Grabitja, gjykata franceze i akordon 1 euro Kim Kardashian](#)

Një gjykatë në Paris i akordoi të martën 1 euro (1.15 dollarë) Kim Kardashian si dëmshpërblim, pasi ajo ishte viktimë eum...

SHOWBIZ 16 Shtator18:55

[Rogert Sterkaj i kërkon në gjykatë fitueses së “BBV4” 10 mijë euro](#)

Rogert Sterkaj ka kërkuar asistencë ligjore pranë avokates Aurora Marku lidhur me paratë e çmimit të fituar nga Selin Bollati dh...

SHOWBIZ 16 Shtator15:06

[Maluma bëhet baba për herë të dytë, zbulon emrin e veçantë të djalit](#)

Familja e Maluma-s është zgjeruar sërish! Këngëtari kolumbian dhe partnerja e tij, Susana Gómez, kanë mirëpritur n&eum...

SHOWBIZ 15 Shtator23:14

[Nora publikon video ‘të nxehta’ nga pushimet](#)

Këngëtarja e njohur shqiptare, Nora Istrefi vazhdon të jetë njëra ndër këngëtares me të pëlqyera për publ...

SHOWBIZ 15 Shtator22:43

[Substancë para plazmaferezës? Misteri i vdekjes së këngëtarit grek Giorgos Mazonakis, çfarë dyshojnë hetuesit](#)

Hetimi për vdekjen e Giorgos Mazonakis po merr një tjetër drejtim, ndërsa autoritetet greke po fokusohen te provat dixhitale të sekuest...

SHOWBIZ 15 Shtator22:35

[Bebe Rexha flet për vizitat e shpeshta që bënte në Maqedoni gjatë fëmijërisë: Dasmat shqiptare zgjasnin deri në 3 të mëngjesit](#)

Këngëtarja shqiptare me famë ndërkombëtare, Bebe Rexha, ka folur së fundmi për kujtimet e saj të fëmijërisë&eum...

SHOWBIZ 15 Shtator22:13

[“Ky vit do të jetë ndryshe”, Xhensila Myrtezaj me premtim të madh për fansat](#)

Këngëtarja e njohur, Xhensila Myrtezaj, ka ndarë me ndjekësit disa momente nga koncertet e saj, duke shoqëruar fotografitë dhe vid...

SHOWBIZ 15 Shtator22:01

[Ka gjetur dashurinë pas divorcit? Këngëtarja Maya “hap zemrën”](#)

Këngëtarja e njohur Maya Aliçkaj ka folur për jetën e saj private gjatë një interviste duke treguar se aktualisht jeton vet...

SHOWBIZ 15 Shtator20:56

[Selin Bollati zbulon se çfarë ndodhi me 100 mijë eurot e fituara nga BBVA](#)

Fituesja e edicionit të pestë të reality show-t “Big Brother VIP Albania”, Selin Bollati, ka ndarë prapaskenat e përvoj&eum...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...](#)

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

BOTA 16 Shtator

[VIDEO- Dy aksidente me pesë viktimë/ Prezantues...](#)

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetare televi...

KOSOVA 16 Shtator

[Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...](#)

Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...


video



E premte | ? 20:45 | Syri TV




E premte | ? 20:45 | Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.